



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJETLLËS KANALIZIME VLORË SH.A

Nr._____, Prot.

Vlorë, më _____.____.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Ruajtja e objekteve dhe e ambienteve rrethuese të Sh.R.U.K Vlorë me roje private të sigurisë fizike dhe sisteme elektronike alarmi”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

79713000-5 - Shërbime roje/shërbime

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit: 46,814,112 (dyzete e gjashte milion e teteqind e katermbedhjetë mijë e njëqind e dymbëdhjetë) **Lekë Pa TVSH** ose **487,038** (katerqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e tridhjetë e tete) **Euro pa Tvsh. Referuar kursit të këmbimit të B.SH datë 11.03.2026, 1 euro = 96.12 All**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Vlorë sha** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenet 76, 82 dhe 83 të LPP dhe Nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

1. Licensë e nënkategorisë 1.3.A për shoqërinë, e vlefshme për ushtrimin e aktivitetit të “Shërbimit të ruajtjes dhe/ose sigurisë fizike”, nënkategoria 1.3.A, “Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private si dhe veprimtarive social kulturore, sportive fetare e politike”, lëshuar nga QKL;

Argumentimi: Kriteri është vendosur në mbështetje të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4, gërma (a) të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, si dhe në mbështetje të ligjit nr.75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, Neni 7 “Kategoritë e licencës” ku specifikisht përcaktohet:

Licencat, sipas këtij ligji, ndahen në dy nënkategori:

a) nënkategoria 1.3.A, “Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private, i personave, si dhe veprimtarive social-kulturore, sportive, fetare e politike”, i cili ushtrohet në të gjithë territorin e vendit;

Referuar specifikave të vendosura nga autoriteti kontraktor për këtë objekt prokurimi është përcaktuar licencë për ushtrimin e aktivitetit në nënkategorinë 1.3.A.

2. Çertifikatë e drejtuesit teknik për ushtrim të aktivitetit konform Ligjit nr.75/2014, datë 10.07.2014 i ndryshuar. Kjo certifikatë duhet të jetë lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit për kategorinë “1.3.A”;

Argumentimi: Kriteri është vendosur në mbështetje të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4, gërma (a) të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, si dhe në mbështetje të ligjit nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, Neni 14 “Kriteret për liçencim” ku specifikisht përcaktohet:

1.Për pajisjen me licencë të nënkategorisë 1.3.A subjekti duhet të plotësojë këto kritere:

a) të jetë i regjistruar në QKR si sh.a. ose sh.p.k. dhe të ketë përcaktuar më parë drejtuesin teknik për këtë veprimtari;

b) titullari i subjektit të jetë i pajisur me certifikatën e nënkategorisë 1.3.A;

c) drejtuesi teknik të jetë i pajisur me certifikatën e nënkategorisë 1.3.A dhe të jetë me kohë të plotë pune;

ç) të ketë lidhur kontratë pune ndërmjet titullarit dhe drejtuesit teknik.

Referuar specifikave të vendosura nga autoriteti kontraktor për këtë objekt prokurimi është përcaktuar se për pajisjen me licencë të shoqërisë në nënkategorinë 1.3.A. është e detyrueshme që titullari i subjektit të jetë i pajisur me certifikatë të nënkategorisë 1.3.A.

3. Çertifikatën e Titullarit të Subjektit të Shoqërisë e cila duhet të jetë e vleshme dhe t'i përkasë ushtrimit të aktivitetit të Kategorisë "1.3.A", konform Ligjit Nr.75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike" i ndryshuar dhe Udhëzimit Nr.150 dt. 16.08.2024 të Ministrisë të Brendshme "Për Funkcionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike";

Argumentimi: Kriteri është vendosur në mbështetje të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4, germa (a) të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", e ndryshuar, si dhe në mbështetje të ligjit nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike", Neni 14 "Kriteret për liçencim" ku specifikisht përcaktohet:

1.Për pajisjen me licencë të nënkategorisë I.3.A subjekti duhet të plotësojë këto kriterë:

a) të jetë i regjistruar në QKR si sh.a. ose sh.p.k. dhe të ketë përcaktuar më parë drejtuesin teknik për këtë veprimtari;

b) titullari i subjektit të jetë i pajisur me çertifikatën e nënkategorisë I.3.A;

c) drejtuesi teknik të jetë i pajisur me çertifikatën e nënkategorisë I.3.A dhe të jetë me kohë të plotë pune;

ç) të ketë lidhur kontratë pune ndërmjet titullarit dhe drejtuesit teknik.

Referuar specifikave të vendosura nga autoriteti kontraktor për këtë objekt prokurimi është përcaktuar se për pajisjen me licensë të shoqërisë në nënkategorinë I.3.A. është e detyrueshme që titullari i subjektit të jetë i pajisur me çertifikatë të nënkategorisë I.3.A.

4. Çertifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën njëzetë e nëntë punonjës shërbimi, të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Vlorë.

Argumentim: Kërkesat e mësipërme janë vendosur në mbështetje të ligjit nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike" në mbështetje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 77, pika 4 si dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar, Neni 41 pika 4, germa (b). Në bazë të udhëzimit të brendshëm nr. 130, datë 05.03.2018, për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike, përcaktohet se numri minimal i punonjësve të shërbimit duhet të jetë 29 roje dhe 17 sisteme elektronike alarmi si dhe 43 sisteme elektronike alarmi + kamera për të gjitha objektet e Sh.R.U.K.Vlorë. Firma kontraktuese është e detyruar të ruajë objektin e mësipërm me këtë numër rojesh.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit 2022, 2023, 2024 të konfirmuara me vule pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilët plotësojnë 2 nga 3 kërkesat e mëposhtme "c" të nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" të ndryshuar; krahas bilanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore. Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkojnë një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitetin sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji”, si dhe kërkesave të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, paraqitja e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.2 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron mesatare vjetore të realizuar për tre viteve të fundit 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 , pika 1 , pika 2 si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, nenin 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (a) të nenit 43, Seksioni III të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar: Kërkohe vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024, në një vlerë jo më të vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit, referuar nenin 43 pika 2/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, pasi kjo është një procedurë **e Hapur- mbi kufirin e lartë monetar**, dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare dhe kapaciteteve ekonomike të operatorëve ofertues, se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më e vogël se 40% e vlerës limit të kontratës që prokurohet. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përllogaritur të fondit limit për këtë lot. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim :

2.4.1 Operatori Ekonomik ofertues duhet të vërtetojë që disponon Licensë/Autorizim për ngritjen dhe shfrytëzimin e sistemit të pavarur të radiokomunikacionit dhe riolarmit të lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Postare dhe Elektronike (AKEP) konform Ligjit Nr. 54/2024 datë 30.05.2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të vlefshëm me fushë mbulimi në qarkun ose qytetet ku ndodhen objektet.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, Neni 41 pika 4 gërma a, si dhe ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” neni 77. Gjithashtu përcaktimi i këtij kriteri është bazuar në llojin e shërbimit, policitë private kanë detyrimin ligjor për të qenë të licencuar nga AKEP për të pasur një sistem radiokomunikimi të pavarur, për të garantuar një komunikim me një nivel të lartë sigurie, për shkak të informacionit sensitiv që mund të transmetohet mes tyre.

2.4.2 Operatori ofertues duhet të paraqesë Aktin e Miratimit të Zyrës së Menaxhimit të Shërbimeve të SHPSF, miratuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë sipas udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme "Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 41, pika 4, gërma "a" e VKMnr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", Ligji nr. 75/2014 "Per sherbimin Privat te sigurise fizike" si dhe Udhëzimit të Ministrit të Brendshme nr.130, date 05.03.2018 "Per funksionimin e sherbimit privat te sigurise".

2.4.3 Vërtetim Performance lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Vlorë, lëshuar në vitin 2026 ku të jepen të dhënat si më poshtë: Mos të ketë shkelje të konstatuara dhe masë administrative të marrë nga Drejtoria Vendore e Policisë ku operatori ushtron aktivitet nga Janari 2024 e në vazhdim; Numrin e punonjësve të certifikuar (kategoria 1.3 A), minimumi 29 (njëzetë e nëntë) punonjës shërbimi roje; Një përgjegjës shërbimi; Operator në qëndrën/Zyrën e Menaxhimit të Shërbimeve 24 orë; Të ketë grup të gatshëm 10 punonjës; Numrin e armëve të gjata jo me pak se 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin public", nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", e ndryshuar, si dhe të ligjit ligjit nr.75/2014, datë 10.07.2014, 'Per sherbimin privat te sigurise fizike", të ndryshuar si dhe akteve nenligjore të dala në zbatim të tij.

2.4.4 Operatori ekonomik për realizimin me sukses të kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore minimumi 29 punonjës shërbimi si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin. Për plotësimin e këtij kriteri Operatori ekonomik duhet të paraqesë Vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për TRE muajt e fundit (Nëntor -Dhjetor 2025 dhe Janar 2026), shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë: Duke marrë në konsideratë objektet që do të kryhet shërbimi.

2.4.5 Ofertuesi duhet të disponojë së paku **3 automjete** për ndërhyrje në raste emergjente, në pronësi të shoqërisë apo të marrë me qira me kontrate (ku të specifikohet qëllimi dhe afati në përputhje me objektin dhe afatin e shërbimit të kërkuar). Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë: Lejen e Qarkullimit dhe taksat e automjetit në pronësi të shoqërisë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë mjetet e nevojshme në dispozicion për realizimin në kohe dhe me sukses të kontratës.

Për kryerjen me efikasitet të shërbimit, mjetet e shërbimit janë si një domosdoshmëri për ndërhyrje në mënyrë urgjente në rast ngjarje për të ardhur në ndihmë rojes së sigurisë dhe objektit që ai ruan nga grupet e gatshme të shoqërisë.

2.4.6 Operatori ekonomik për mirëmbajtjen e sistemeve elektronike duhet të vërtetojë se ka në stafin e tij: Të paktën 1 (një) inxhinier elektronik ose informatik, jo më pak se 3 (tre) punonjës të trajnuar për sistemet e alarmit, për të cilët operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë trajnimit nga kompani të licencuara, Jo më pak se 3 (tre) punonjës të certifikuar në fushën e CCTV nga një prodhues kamerash vendas/ndërkombëtar ose nga distributori i autorizuar i prodhuesit, apo certifikata apo me dëshmi ekuivalente të formimit profesional, të lëshuara nga autoritete/institucione/ente të autorizuar për lëshimin e tyre me qëllim mirëmbajtjen e sistemit të kamerave.

Për të provuar kriteret e mësipërme operatori ekonomik duhet të paraqesë:diplomat përkatëse për inxhinierin elektronik ose informatik, (listëpagesat e sigurimeve shoqërore për gjithë stafin e sipërkërkuar sipas formatit E-Sig për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, ku punonjësit e kërkuar duhet të figurojnë në këto listpagesa të siguruar me kodin përkatës për tre muajt e fundit Nëntor -Dhjetor 2025 dhe Janar 2026.

Argumentimi: Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë është kërkuar personel i nevojshëm staf teknik referuar shërbimit që duhet të kryhet nga operatorët ekonomikë për monitorimin në distancë me kamera dhe sisteme alarmi në mbështetje të pikës 4 të Nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se “në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” si dhe në mbështetje të Nenit 41 të VKM Nr. 285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, pika 4, germa (b) ku specifikisht përcaktohet: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: :..... një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose...”

Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit të prokurimit. Sqarojmë se, stafi teknik është kërkuar në përputhje me termat e referencës ku kërkohet specifikisht që operatori ekonomik të kryejë krahshërbimit me roje fizike dhe shërbimin e monitorimit në distancë duke instaluar kamera dhe sisteme alarmi të cilat do të integrohen në platformën monitoruese në sallën e autoritetit kontraktor. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohej që implementimi i pajisjeve dhe integrimi i tyre do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e tyre sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike dhe termat e referencës. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar kodi përkatës në listëpagesat për periudhën Nëntor -Dhjetor 2025 dhe Janar 2026, si dhe kontrata e punës respektive.

Në përshkrimin e termave të referencës vërejmë se në objektet në ruajtje do të vendosen sistemet e kamerave dhe të alarmit në mbështetje të shërbimit me roje fizike. Lidhur me vendosjen e sistemeve të mësipërme dhe integrimin e tyre, prodhuesit kanë ndërtuar programe trajnimit dhe kontrolli të shoqërive dhe individëve të cilët mund të kryejnë shërbime që lidhen me zbatimin apo mirëmbajtjen e këtyre sistemeve. Në kuadër të këtyre programeve prodhuesit vendosin kritere teknike, organizative për burimet njerezore dhe për procedurat e brendshme të shoqërive. Këto programe/kushte ndërtohen nga vetë prodhuesit dhe ata në këtë mënyrë marrin përsipër cilësinë e shërbimeve të ofruara nga shoqëritë. Në shumë raste, kalimi i certifikimeve i kualifikon shoqëritë si të autorizuar prej tyre për realizimin e shërbimeve të ndërhyrjes, përmirësimit apo përditësimit të sistemeve të kamerave apo sistemeve të alarmit. Nëse shoqëritë nuk kanë punonjës të certifikuar nga prodhuesit (për sisteme) çdo ndërhyrje në sistem rrezikon përfundimin e kushteve të garancise apo të mirëmbajtjes së prodhuesit.

Për këtë, certifikimet e mësipërme që kanë lidhje me sistemet e kamerave dhe të alarmit që kërkohen si pjesë e integruar e shërbimit jo vetëm që përbëjnë një nevojë për garantimin e cilësisë së shërbimit, por ato janë direkt të lidhura edhe me kërkesat e prodhuesve për mirëmbajtjen. Ndërhyrjet në sistem nga punonjës të pa-certifikuar mundet të dëmtojnë vetë sistemin, të dhënat që mbahen në sistem dhe/ose në kuadrin e sigurisë së informacionit apo të bëhen shkak për aksesin ose dëmtimin e informacionit nga/në persona apo drejtime të paautorizuara.

Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për tu garantuar që Operatori Ekonomik ka mbështetjen e prodhuesit për të garantuar cilësinë e produkteve të nevojshme për realizimin e shërbimit dhe instalimin e tyre në kohë për përmbushjen me sukses të kontratës, duke garantuar funksionimin e sistemeve të kamerave dhe alarmit nga persona të autorizuar.

2.4.7 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin analizën e kostos për ofertën e paraqitur.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar me qëllim respektimin e ligjshmërisë në përlllogaritjen e çmimit të kontratës dhe moslejimin e ofertave financiare të papërgjegjshme të cilat nuk garantojnë zbatimin me sukses të kontrates.

➤ Argumentimi i specifikimeve teknike :

Referuar shërbimit që kërkohet të kryhet, atij të ruajtjes me roje private dhe monitorimit në distancë, bazuar në termat e referencës dhe specifikimet teknike të hartuara nga Grupi i punës për Përcaktimin e fondit limit, duke qënë se ato, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”,

i ndryshuar, njësia e prokurimit kreu miratimin e specifikimeve teknike për shërbimin objekt prokurimi.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performancë, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

➤ **Sqarim në lidhje me mosndarjen e procedurës në Lote:**

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, parashikohet shprehimisht:

- 1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.*
- 2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.*

Pas analizës teknike dhe organizative, është arritur në përfundimin se ndarja e kësaj procedure në lote nuk është e përshtatshme dhe nuk do të ishte në interes të autoritetit kontraktor për arsyet e mëposhtme:

Së pari, shërbimi i ruajtjes së objekteve dhe ambienteve të Sh.R.U.K Vlorë përbën një shërbim të integruar, i cili kërkon koordinim të vazhdueshëm ndërmjet rojeve fizike të sigurisë dhe sistemeve elektronike të alarmit. Ndarja në lote do të sillte mundësinë e përfshirjes së operatorëve ekonomikë të ndryshëm për komponentë të ndryshëm të shërbimit, gjë që do të vështirësonte koordinimin operacional dhe përgjegjësinë për garantimin e sigurisë.

Së dyti, menaxhimi i kontratës dhe monitorimi i zbatimit të saj do të bëhej më kompleks në rast të ndarjes në lote, duke krijuar vështirësi në përcaktimin e përgjegjësisë në rast incidentesh apo mosfunksionimi të sistemeve të sigurisë.

Së treti, sigurimi i një operatori të vetëm ekonomik për realizimin e të gjithë shërbimit garanton një nivel më të lartë përgjegjshmërie, koordinimi dhe reagimi të shpejtë në situata emergjente, si dhe një menaxhim më eficient të shërbimit.

Gjithashtu, duke qenë se objektet dhe ambientet që do të ruhen janë pjesë e një sistemi të vetëm funksional dhe administrativ, ofrimi i shërbimit nga një operator i vetëm ekonomik konsiderohet më efektiv dhe ekonomik për autoritetin kontraktor.

Për sa më sipër, autoriteti kontraktor vlerëson se **mosndarja e procedurës në lote është e justifikuar**, pasi garanton ofrimin e një shërbimi të unifikuar, rrit efikasitetin e menaxhimit të kontratës dhe siguron një nivel më të lartë sigurie për objektet dhe ambientet e Sh.R.U.K Vlorë.

Njesia e Prokurimit
